



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 26.07.2021, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fridon Lala, Agon Batusha, Arjeta Fejza, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Branislav Nikoliq dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Arbëresha Kryeziu Hyseni, Ardian Kastrati dhe Blerta Deliu Kodra.

Stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GLPS, GIZ-i, OSBE-ja, KDI-ja dhe përfaqësuesit e mediave.

Mbledhjen e kryesoi : Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.7.2021;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja, në fillim kërkoi nga anëtarët e komisionit një minutë heshtje për viktimat në tragjedinë e ndodhur në Kroaci.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.7.2021

Procesverbali nga mbledhja e datës 14.7.2021 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se bazuar në vendimin e seancës plenare të datës 16 korrik 2021, ne si Komision kryesor kemi sot afatin për shqyrtimin e këtij projektligji dhe amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional, prandaj edhe është thirrur kjo mbledhje, bazuar në atë vendim, pasi që kemi pranuar raportin me amendamente nga Komisioni funksional.

Qëllimi i këtij projektligji është të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 07/L-041 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Siç e kemi parë, ky projektligj përmban gjithsej 14 nene dhe 35 amendamente të Komisionit funksional.

Bazuar në fushë-veprimtarinë e Komisionit, ne jemi përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha projektligjeve nga aspekti i përputhshmërisë së tyre me legjislacionin e BE-së, prandaj si të tillë ne mund ta rekomandojmë për miratim të mëtejme, duke pasur parasysh se ky projektligj dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk trans pozojnë ndonjë legjislacion të BE-së, pra, janë kompetencë e brendshme e secilit shtet për rregullimin e kësaj fushe.

Time Kadrijaj, tha se në aspektin e përputhshmërisë nuk kemi asgjë kundër por ne si opozitë dhe si grup parlamentar i kemi kundërshtimet e tona sepse e konsiderojmë se është një buxhet politik, ngase kemi konstatuar se me këtë rishikim të buxhetit janë dëmtuar shumë komunat, andaj ne do të abstenojmë dhe nuk do të marrim pjesë në votim.

Kryetarja, pas votimit konstatoi se me shumicë votash Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Çështjet e rregulluara dhe të adresuara në Projektligjin nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, andaj si i tillë rekomandohet për miratim të mëtejme.

4. Të ndryshme.

Kryetarja, njoftoi lidhur me organizimin e vizitës në Komunën e Prizrenit që ka qenë e planifikuar që të realizohet nesër. Janë bërë përpjekje nga ana e stafit, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Do të bëjmë përpjekje që kjo vizitë të realizohet sapo të marrim ndonjë përgjigje nga ana e tyre.

Agon Batusha, tha se do te ishte mirë që në mbledhjet e ardhshme bashkërisht të planifikojmë të diskutojmë për pronën intelektuale dhe po ashtu edhe për të drejtat e punëtorëve sepse i takojnë legjislacionit të BE-së, varësisht prej diskutimeve tona ne ti ftojme personat përgjegjës

dhe të diskutojmë me ta dhe të shohim zbatueshmërinë e këtyre ligjeve, për te cilat ka shumë vërejtje në praktikë .

Në vazhdim bëri të ditur se më 9 qershor 2021, Kryetari i Kuvendit ka mbajtur një takim me Kryetarët e Komisioneve të Kuvendit të Kosovës, ku është prezantuar Plani për Mbikëqyrjen e Procesit Integrues 2020-2021.

Ky plan ka për qëllim mbikëqyrjen e adresimit të të gjeturave nga Raporti për Vandin për vitin 2020.

Bazuar në udhëzimin e përgatitur, lidhur me këtë Plan, Njësia për Integrim Evropian e Kuvendit të Kosovës është përgjegjëse për përgatitjen dhe mbledhjen e raporteve nga ana e Komisioneve dhe pas përgatitjes së raportit të njëjtin e përcjellë në Komisionin tonë për shqyrtim dhe e dërgon për seancë plenare.

Në këtë drejtim, ne si Komision kemi pasur dy pika për të cilat kemi dërguar një e-mail në zyrën e Kryeministrit dhe kemi marrë përgjigje nga ana e tyre dhe të njëjtat të dhëna do të procedohen në Njësinë për Integrim Evropiane, ku pastaj do të marrim dokumentin komplet me të dhënat edhe nga Komisionet e tjera.

Dy pikat që ndërlidhen me Komisionin tonë janë: 1. Të përmirësohet zbatimi i reformave të MSA/ARE; dhe 2. Të forcohet koordinimi, planifikimi dhe monitorimi i asistencës nga donatorët.

Prandaj, pasi të marrim dokumentin nga Njësia për Integrim Evropiane, do t’jua dërgojmë paraprakisht në e-mail dhe pastaj do ta diskutojmë edhe në Komision dhe të njëjtin ta rekomandojmë për diskutim në seancë plenare.

Takimi përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Rrezarta Krasniqi